



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300661/9

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjeno-sanitare të banorëve të fshatit Rrungaj, në Njësinë Administrative Libofshë, Bashkia Fier

NDËRMARRJES SË UJËSJELLËS-KANALIZIME SH.A FIER

FIER

BASHKISË FIER

NJËSISË ADMINISTRATIVE LIBOFSHË

FIER

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar me iniciativë rastin e bërë publik në median *online*¹ lidhur me shqetësimin e banorëve të fshatit Rrungaj, Njësia Administrative Libofshë, në Fier për mungesën e furnizimit me ujë të pijshëm. Artikulli përshkruante se banorët e fshatit Rrungaj ankohen se u mungon uji i pijshëm. Në këtë fshat jetojnë 35 familje, të cilat kanë fëmijë të vegjël. Pavarësisht ankesave të vijueshme, problematika e tyre nuk ka gjetur ende zgjidhje.

¹<https://www.syri.net/sociale/608106/syri-tv-fshati-rrungaj-i-braktisur-nga-shteti-banoret-nuk-kemi-rruge-dhe-ujë/>

Me qëllim garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të banorëve të kësaj zone, duke e konsideruar të drejtën e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm, si një nga të drejtat kryesore që lidhen me cilësinë e jetës, shëndetin dhe mjedisin, dhe pa diskutim ndikimin që ka tek jeta dhe shëndeti i fëmijëve, në përputhje me nenin 13 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) Avokati i Popullit filloi me iniciativë ndjekjen e kësaj çështje.

Është detyrë e çdo institucioni publik, që në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, të garantojmë me efektivitet ushtrimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe gëzimin prej tyre të një jetese të shëndetshme.

Ndaj, bazuar në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në gërmën “b” të nenit 19 të ligjit nr. 8454/1999, i kemi kërkuar informacion të hollësishëm² Bashkisë Fier dhe Njesisë Administrative Libofshë, lidhur me situatën në fshatin Rrungaj, dhe masat që do të merren për trajtimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në interesin më të lartë të fëmijëve.

Në përgjigje të këtyre kërkesave, nga Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier me shkresën nr.966/1 prot., datë 28.07.2023, jemi informuar se “Për sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, ky shërbim mbulohet nga Ujësjiellës Kanalizime Fier. Nga interesimi i bërë pranë kësaj Ndërmarrjeje rezulton se vetëm shtatë familje të këtij fshati nuk furnizohen me ujë të pijshëm, pjesa tjetër merr ujë rregullisht. Për këto shtatë familje dikur është lënë një çezmë publike, por në kushtet kur kjo gjë nuk është lejuar me ligj, është ndërprerë. Familjet duhet të paraqiten me kërkesë pranë Ujësjiellës Kanalizime Fier për lidhjen e kontratave të ujit, në mënyrë që të mundësohet ky shërbim. Njësia administrative Libofshë do t’ja përcjellë shqetësimin e banorëve, Ndërmarrjes së Ujësjiellës Kanalizimeve, e cila ka kaluar në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”.

Ndërkohë, nga Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve Fier, pavarësisht kërkesave për shpjegime³ të Avokatit të Popullit, nuk ka patur reagim.

Avokati i Popullit, ka vijuar trajtimin administrativ të problematikës, duke iu drejtuar Njesisë Administrative Libofshë, në vijim të përgjigjeve të kthyera nga kjo e fundit. Referuar shkresës me nr.K5/I29-6 prot., datë 27.05.2024, i kërkuam një informacion lidhur me trajtimin e mëtejshëm të

² Shkresa me nr.K5/I29-2 prot., datë 20.07.2023

³ Shkresa me nr.K5/I29-4 prot., datë 25.01.2024 dhe shkresa me nr.K5/I 29-5 prot., datë 27.05.2024

kësaj problematike, masat që mund të jenë ndërmarrë dhe nëse tashmë ka marrë zgjidhje furnizimi me ujë të pijshëm i shtatë familjeve në fshatin Rrungaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigjen e saj, me shkresën nr.758/1 prot., datë 5.06.2024, Njësia Administrative Libofshë, ka bërë me dije se Administratorja e kësaj Njësie me shkresën nr.970 prot., datë 31.07.2023 i ka kërkuar Ujësjiellës-Kanalizimeve Fier, marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të fshatit Rrungaj. Në këtë shkresë, i kanë kërkuar verifikimin e situatës në vend, si dhe të shikohet mundësia për shtrirjen e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm në këto familje.

Avokati i Popullit vlerëson se rasti i parashtruar përbën shkelje të së drejtës themelore për ujë të pijshëm dhe higjienë, si çështje specifike këto të lidhura ngushtë me shëndetin, jetën dhe dinjitetin e njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbrojtje të interesave të ligjshme të konsumatorit, kërkon të sjellë në vëmendjen tuaj marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm, brenda gjithë kushteve higjeno-sanitare në mënyrë të vazhdueshme për këta banorë, si një nevojë emergjente. Duke e vlerësuar të drejtë dhe të ligjshëm shqetësimin e ngritur nga banorët fshatit Rrungaj, Avokati i Popullit kërkon vëmendjen Tuaj për trajtimin e saj, lidhur me mangësitë e furnizimit me ujë të pijshëm, bazuar në misionin e punës Tuaj, si dhe koordinimin dhe monitorimin e aktivitetit për sigurimin e furnizimit me ujë. Sa më sipër, ushtrimi i detyrave tuaja funksionale dhe marrja e masave të menjëhershme për garantimin e furnizimit me ujë të pijshëm, janë të domosdoshme dhe urgjente në rastin konkret.

E drejta e aksesit në ujë të pijshëm parashikohet si e drejtë e njeriut nga një sërë aktesh ndërkombëtare konkretisht, Direktiva e Ministrave të BE 2020/2184⁴; Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara⁵; Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 58/217, “Ujë për gjithë jetën”⁶; Rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 15/9, “Të

⁴ Directive (EU) 2020/2185 of the European Parliament and of the Council of 16 December 2020 on the quality of water intended for human consumption. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32020L2184>

⁵ Veçanërisht objektivi nr. 6, Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe shërbimeve sanitare për të gjithë. Nënobjektivi 6.b parashikon mbështetjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së komuniteteve lokale në përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe kanalizimeve. <https://sdgs.un.org/goals/goal6>

⁶ Resolution adopted by the General Assembly 58/217. International Decade for Action, “Water for Life”. <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/507/54/PDF/N0350754.pdf?OpenElement>

drejtat e njeriut dhe aksesin në Ujë të Pijshëm dhe Higjenë (2010)”⁷. Në Udhëzuesin e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e Konsumatorit⁸, thuhet se: *“Qeveritë duhet që brenda objektivave dhe synimeve të përcaktuara në Dekadën Ndërkombëtare për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për higjenën, të formulojnë, të mbajnë dhe fuqizojnë politikat kombëtare për të përmirësuar furnizimin, shpërndarjen dhe cilësinë e ujit të pijshëm.....”*.

Këto akte ndërkombëtare përbëjnë një kompleks normash që garantojnë aksesin në ujë, sigurinë e ujit të pijshëm, përshtatshmërinë e furnizimit dhe përballueshmërinë ekonomike, të drejtën për higjenë të pastër dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, duke vendosur kështu kritere të detyrueshme për shëndetin dhe pastërtinë.

Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm⁹ dhe 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG), të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, përbëjnë një shtysë të re në përpjekjet globale, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm. Asambleja e Kombeve të Bashkuara u ka bërë thirrje Shteteve Anëtare që, midis të tjerash, *“të garantojnë që strategjitë kombëtare të shëndetit të kontribuojnë në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit që lidhen me ujin dhe kanalizimet ndërkohë që mbështesin realizimin progresiv të të drejtës së njeriut për ujë dhe kanalizime që i japin të drejtë kujtudo, pa diskriminim, për të pasur ujë dhe kanalizime që janë të mjaftueshme, të sigurta, të pranueshme, fizikisht të aksesueshme dhe të përballueshme për përdorim personal dhe familjar*¹⁰.

E drejta për shërbim të sigurt të ujit dhe kanalizimeve është e drejtë universale e njeriut. Një sistem i mirë funksionues i furnizimit me ujë është detyrë kyçe e shërbimit publik dhe gjithashtu një parakusht për jetë të shëndetshme. Gjithashtu sistemimi i ujërave dhe kanalizimeve është detyrë kryesore për realizimin e agjendës së politikës mjedisore.

Edhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës ka theksuar rëndësinë e sigurimit të ujit të pijshëm të pastër: *“Uji i pijshëm dhe i pastër*

⁷ Resolution adopted by the Human Rights Council, 15/9: Human rights and access to safe drinking water and sanitation. <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G10/166/33/PDF/G1016633.pdf?OpenElement>

⁸ United Nations Guidelines for Consumer Protection. https://unctad.org/system/files/official-document/ditccplpmisc2016d1_en.pdf

⁹ OZHQ 6-Ujë i pastër dhe kanalizime, *Nënobjektivi.6.1*-Deri në vitin 20230 të arrihet furnizimi i gjithanshëm dhe i barabartë me ujë të pijshëm, të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë. *Nënobjektivi 6.4*- Deri në vitin 2030 të rritet ndjeshëm përdorimi efikas i ujit në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqja e qëndrueshme e tij dhe furnizimi me ujë të pijshëm, për të adresuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njëzve që vuajnë nga mungesa e ujit.

¹⁰ Rezoluta 64/24, 2011

dhe kanalizimet janë thelbësore për jetën e gëzimin e të gjitha të drejtave të njeriut¹¹. Autoritetet qendrore dhe vendore përgjegjëse për ujin dhe kanalizimet *duhet të njohin detyrimin që kanë për realizimin e të drejtës së fëmijëve për kujdes shëndetësor dhe duhet të kenë në konsideratë vazhdimisht treguesit (indikatorët) për kequshqyerjen e fëmijëve, diarrenë dhe sëmundjet e tjera të lidhura me ujin dhe madhësinë (përmasat) e familjes gjatë planifikimit dhe kryerjes së punimeve për zgjerimin e infrastrukturës së mirëmbajtjes e furnizimit të ujit, si dhe ofrimin e furnizimit me ujë gjatë marrjes së këtyre vendimeve, për vendosjen e tarifave minimale ose falas dhe kur sistemi nuk funksionon. **Shtetet nuk përjashtohen nga këto detyrime, edhe kur i kanë privatizuar furnizimin me ujë dhe kanalizimet.***

Neni 24 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, ka përcaktuar se “**Shtetet Palë** njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë, dhe **në veçanti marrin masat e duhura:** (c) Për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të përdorimit, ndër të tjera, të teknikave lehtësisht të arritshme si dhe të sigurimit të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe **ujit të pijshëm të pastër**, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror”.

Kushtetuta e RSH-së në nenin 54, ka përcaktuar të drejtën e fëmijëve, për mbrojtje të veçantë nga shteti. Po ashtu, ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” ka parashikuar të drejtën e fëmijës për të gëzuar një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror, si dhe interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ju vë në dukje faktin se, të drejtat e konsumatorëve (banorët e fshatit Rrungaj), për furnizimin me ujë, janë kufizuar nga mosveprimi i autoriteteve përgjegjëse, që kanë detyrimin të ndërmarrin masa pozitive për përmbushjen e interesit jetik, të furnizimit me ujë të banorëve të fshatit.

Ligji Nr. 9902 datë 17.04.2008, “*Për mbrojtjen e konsumatorit*”, neni 4, pika “e”, ndër të tjera parashikon si të drejta bazë për konsumatorin edhe ofrimin e shërbimeve publike, që në rastin konkret nënkuptojnë furnizimin me ujë të pijshëm dhe sigurimin e standardeve për këtë shërbim. Çdo justifikim i përdorur për mosofrimin e këtij shërbimi jetik, në kushtet e evidentuara gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, nuk është i qëndrueshëm dhe i arsyeshëm. Ofrimi

¹¹ Komiteti i OKB për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i përgjithshëm nr. 15 (2013) mbi të drejtën e fëmijës për standardin më të lartë të shëndetit (neni 24), paragrafi 48.CRC/C/GC/15 <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g13/428/14/pdf/g1342814.pdf?token=45whz1srdQHIX8d2Tb&fe=true>

i shërbimit publik të furnizimit me ujin të pijshëm dhe cilësor, në gjykimin tonë është një nevojë thelbësore për individët dhe për rrjedhim, një e drejtë elementare për ta poseduar atë lirisht dhe në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë së ujit të pijshëm. Ndaj edhe çdo mospërmbushje apo keqmenaxhim i këtij shërbimi është një shkelje e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut që nuk i përgjigjet standardeve minimale që duhet të plotësojë një vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Mungesa e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm jo vetëm që ndikon në cilësinë e jetës së banorëve të kësaj zone, por në këndvështrimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, çënon të drejtën e tyre për gëzimin e qetë të shtëpive të tyre, si dhe çënon të drejtën për jetë të qetë private dhe familjare¹².

Qasja që pritet të kenë strukturat përgjegjëse në këtë rast, për të mundësuar zgjidhjen e problemit, duhet të jetë proaktive dhe në funksion të interesit më të lartë publik. Mungesa e reagimit të shpejtë apo ofrimit të një zgjidhje të qendrueshme cenon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata publike. Rritja e standardit të veprimtarisë administrative që ushtrojnë organet e administratës në çdo nivel është në qendër të politikave dhe angazhimeve të shtetit shqiptar në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. Qasja proaktive e në zbatim të detyrimit për mirëadministrim e mirëqeverisje (e cila theksohet në mënyrë të veçantë nga Karta e të Drejtave Themelore e BE, si një koncept i cili nevojitet të përvetësohet në veprimtarinë e përditshme të organeve publike), duhet të reflektohet në zgjidhjen e rastit konkret.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, dhe në vijim të nenit 21/b, të ligjit nr.8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut...”*.

REKOMANDOJMË

- Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin normal me ujë të pijshëm dhe brenda kushteve higjieno-sanitare të banorëve (shtatë

¹²Çështja Tatar vs. Rumanisë (Aplikimi nr.67021/01), Çështja Branduse vs. Rumanisë (Aplikimi nr.39951/08) etj.

familjeve) të fshatit Rrungaj, Njësia Administrative Libofshë, Bashkia Fier.

- Njësia Administrative Libofshë të kujdeset për të informuar banorët për detyrimet e tyre dhe procedurat që duhen për përpilimin e kërkesës me synim zgjidhjen e problematikës.
- Marrjen e masave nga Bashkia Fier për të siguruar bashkëpunimin me UK Fier, që të plotësojë detyrimin e furnizimit me ujë të pijshëm, nëpërmjet shtrirjes së rrjetit të furnizimit tek të gjitha banesat e fshatit Rrungaj.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454/1999, organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA